

Tiranë, më 28 Maj 2021

KËRKESË PËR OFERTË
SUBJEKT TREGTAR PËR ORGANIZIMIN E EVENTIT “SHKOLLË VERORE” NË
SHËNGJIN NË DATAT 4-9 KORRIK

Hyrje

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), në zbatim të projektit “Drejt një dialogu më të madh ndërkulturor, ndërbesimtar dhe ndërjetar në Ballkanin Perëndimor”, mundësuar dhe mbështetur financiarisht nga organizata jofitimprurëse donatore DRA, Civic Solidarity Platform dhe Zyra Federale e Jashtme e Republikës Federale të Gjermanisë, shpall kërkesën për ofertë për një subjekt tregtar për organizimin e eventit që do të zgjasë 4 ditë në 4 salla konferencash/mbledhjesh paralele, ofrimin e konsumit të drekës, coffee break dhe konsumit të darkës, akomodimin për 5 netë të 42 personave për organizimin e eventit “shkollë verore”, i cili ofron gjithashtu edhe:

- 4 Salla për organizimin e sesioneve paralele të Shkollës Verore, të përshtatshme për garantimin e respektimit të masave anti Covid-19 për grupe me 10 persona/secila sallë. Qeraja e secilës sallë është parashikuar Full Day, ndërkohë që salla duhet të jetë e pajisur me pajisje lehtësuese për realizimin e eventit si bashkë me pajisjet mbështetëse (mikrofona statikë ose të lëvizshëm dhe audio, video-projektor, flipcharter, internet acces të pandërprerë) Full day.*¹
- Dhoma për akomodimin e pjesëmarrësve (dhoma e përshtatshme për akomodimin 2-3 pjesëmarrësve në secilën)
- Pushim kafeje/Coffee breaks (1 për çdo ditë, në total 5 ditë)
- Shërbim dreke dhe shërbim darke
- Open space të aksesueshëm for Free për pjesëmarrësit në event

Oferta financiare nuk duhet të kalojë vlerat maksimale totale të poshtë shënuara:

- 6300 € për akomodimin e pjesëmarrësve (4-9 Korrik)
- 750 € qera për 4 sallat e mbledhjeve/konferencave, ku do organizohen sesionet paralele (akomodim i rreth 10 personave në secilën sallë)
- 630 € për coffee breaks (1 në ditë, 5 ditë)
- 2730 € për shërbim dreke (42 persona x 5 ditë)

* Në varësi të kufizimeve në fuqi lidhur me masat Anti-COVID mund të realizohet edhe një një sallë, full day për 4 ditë

- 2730 € për shërbim darke (42 persona x 5 ditë)

KShH fton të gjitha subjektet/kompanitë e interesuara që të dërgojnë në formë elektronike në adresën e e-mailit të KShH-së office@ahc.org.al ose postare, deri në datën 03.06.2021, dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Ofertën financiare në Euro (me TVSH të përfshirë) *²
2. Çertifikatën e regjistrimit (nqs ofertuesi është kompani/subjekt tregtar)
3. Oferta duhet të jetë e firmosur dhe e vulosur
4. Foto ose link të sallave ku planifikohet të mbahet event

² *Subjektet që nuk i nënshtrohen TVSH ta deklarojnë këtë status.